



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:263581  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05477327  
**C.nr.4217/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil,** me gjyqtarin Baki Shigjeqi, dhe bashkëpunëtoreshen profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K. me numër personal .... nga fshati .... komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.S.M.N. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 294.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 20.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. **APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K. nga fshati .... komuna e Prizrenit, **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësit në emër të shujtave ditore për 147 ditë pune për vitin 2022 (për periudhën prej datës 10.01.2022 deri më datën 21.11.2022), ti paguaj **shumën e përgjithshme prej dyqindënëntëdhjetekatër euro (294.00€)**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (24.11.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **njëqindnjëzetekatër euro (124.00 €)**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi A.K. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarës së tij av.S.M.N. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 24.11.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shujtave.

E autorizuar e paditësit në padi ka theksuar se paditësit është në marrëdhënie pune pranë SHFMU "Dëshmorët e Hasit, në fshatin Kabash, komuna e Prizrenit, në bazë të kontratës së punë me nr. të protokollit 10, dhe se gjatë vitit 2022, paditësja nga data 10.01.2022 deri me datë 21.11.2022, ka qenë e pranishme në punën për 147 ditë, bazuar në vërtetimin me nr. prot.139/23 i datës 10.11.2023. Tutje ka theksuar se sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, e paditura, ka për obligohet që punëtorëve të arsimit, përkatësisht paditësen ta kompensoj për ushqim gjatë orarit të punës për 2 euro për çdo ditë të paraqitjes në punë, respektivisht për 147 ditë pune në shumën prej 294 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të komunës, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarës së të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në SHFMU “Dy Dëshmorët” në fshatin Kabash, Komuna e Prizrenit.

Nga vërtetimi me nr. të reff:139/2023 i datës 10.11.2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Dëshmorët e Hasit” në fshatin Kabash, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K. është në marrëdhënie pune-mësimdhënës pranë kësaj shkolle dhe i njëjti për vitin 2022, dhe atë nga data 10.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 147 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit të SHFMU “Dëshmorët e Hasit” në fshatin Kabash, Komuna e Prizrenit, gjykata i’a fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe ditët e punës, konkretisht paditësi A.K. është mësimdhënëse në SHFMU “Dëshmorët e Hasit”, në fshatin Kabash, Komuna e Prizrenit, dhe për vitin 2022, dhe atë nga data 10.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 147 ditë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktua e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit-mësimdhënës, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditësin A.K. kërkesa është bërë e arritshme për 147 ditë pune, përkatësisht për periudhën nga data 10.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, apo shuma e përgjithshme prej 294.00 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë (24.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padsisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2023:263581, 20.03.2024

**G j y q t a r i**

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.